



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 13 dhjetor 2023

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10:05

Në mungesë të Kryetarit të Komunës z. Shpejtim Bulliqi, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, z. Bahri Selimi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e KKSB-së: z.Nijazi Jashari, Komandant i Stacionit të Policisë; z.Shefki Selmani, përfaqësues i Kishës Protestante-Podujevë; z.Xhafer Ademi, kryesues i Komitetit për Komunitete dhe përfaqësues i komunitetit rom; znj.Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z.Nazif Sheqa, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit-Podujevë; z.Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z.Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z.Bahri Selimi, përfaqësues i Emergjencave Civile-Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit; z.Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe z.Shemi Jashari, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa munguan: z. Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z.Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom znj.Sevdiqe Mustafa, përfaqësuese e komunitetit egjiptian, z.Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit; znj.Ilirianë Bunjaku, përfaqësuese e FSK-së dhe z.Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: z. Bekim Karagjia dhe z. Ryan Scherba – OSCE; Përfaqësuesi i KFOR-it; z. Eset Qerimi, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame (Në vend të z. Mensur Hoti).

z. Bahri Selimi, përshëndetje për të gjithë anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, më lejoni të ju informojë se në mungesë të Kryetarit të Komunës për shkak të të angazhimeve e hap mbledhjen e KKSB-së. Materialet për mbledhje konsideroj se i keni marrë të gjithë me kohë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës

Rendi i ditës u miratua njëzëri

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 20 tetor 2023

U miratua njëzëri

2. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

- **Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë**
- **Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë**

z. Bahri Selimi, fillimisht rreth kësaj pike fjalën ia kalojmë Komandantit të Stacionit të Policisë z. Nijazi Jashari.

z. Nijazi Jashari, theksoi, do të jem i shkurtër sa i përket raportimit sepse edhe intervali kohorë nga raportimi në mbledhjen e fundit është i shkurtër, ku edhe në formë statistikore ka raportuar zv. Komandantja e Stacionit të Policisë znj. Valbona Blakqori. Statistikat e kësaj periudhe kohore do të përfshihen në raportin vjetor, përkatësisht në takimin e radhës, sepse aktualisht janë duke u nxjerrë. Gjendja e përgjithshme e sigurisë në rajonin e përgjegjësisë së Stacionit të Policisë është stabile dhe e menaxhueshme dhe nën kontrollin e institucioneve të sigurisë. Zhvillimet politike gjatë kësaj periudhe në Republikën e Kosovës nuk kishin ndikim në situatën e sigurisë, aktivitete të ekstremistëve dhe grupeve të ekstremistëve nuk janë raportuar gjatë kësaj periudhe kohore, tensione politike nuk ka pas. Tensione ndëretnike ka qenë një rast por nuk ka pas ndikime të mëdha, tensione religjioze nuk ka pas, po ashtu as tensione sociale, për ndonjë krim të organizuar në këtë periudhë nuk është raportuar, po ashtu në zonën kufitare nuk ka pas raste të raportuara. E përsëris përgjithësisht situata është e menaxhueshme dhe nën kontroll. Kemi pas një plan operativ me përmasa pak më të gjëra, ku vlerësimi i organeve të sigurisë ka qenë rrezikshmëri e lartë, fjala është për lojën e futbollit që u zhvillua në Podujevë me klubin futbollistik përfaqësues të Izraelit. Në këtë rast janë ndërmarr të gjitha masat dhe është kryer në mënyrën më të mirë të mundshme. Sa për njoftim do ju njoftoj në pika të shkurtra për një ngjarje të kisha në fshatin Rakinicë, ku ka pas një angazhim të theksuar nga ana e organeve të sigurisë, por që situata ka qenë e menaxhueshme. Këtu ka pas angazhim edhe të faktorëve të ndryshëm rreth kësaj ngjarjeje por është mirë që në kishë nuk ka dëmtime as demolime, pra nuk kishte diçka që ne do ta bënim si rast, përveç tentimit se kisha është e jona. Kjo situatë është menaxhuar në bashkëpunim me KFOR-in, OSCE dhe Eulex-in, natyrisht edhe me prokurorinë. Ju veç se jeni të njoftuar nga mediat rreth kësaj ngjarjeje, ku ndër tjera ka qenë një informatë se edhe Komuna ka marrë pjesë dhe ne kemi reaguar si Polici por këtu ka reaguar edhe Komuna. Aty ka qenë një individ punëtor i Komunës, që realisht është banor i atij fshati por nuk ka pasur asgjë zyrtare në këtë aspekt. Sa i përket çështjes së personelit të Stacionit Policor ju njoftoj se ka lëvizje të mëdha, fjala vjen në këtë vit në Njësinë Operative na kanë shkuar 7 pjesëtarë me vendim të përhershëm, në stacione tjera kanë shkuar 2 zyrtar, në Njësinë për menaxhimin e kishave i kemi 2 zyrtarë të përhershëm që kanë shkuar, 1 zyrtar ka vdekur, 4 zyrtar policor i kemi në transfer të përkohshëm në njësitë tjera, në detyra të lehta i kemi 9 zyrtar policor dhe ky është problem për menaxhim për çdo stacion policor, jo vetëm për ne, në pension kanë shkuar 6. Na brengos fakti që këtë vit kemi 7 dorëheqje të zyrtarëve policor. Jemi duke operuar me minimumin e veturave zyrtare. Në qarkullim kemi vetëm 3 vetura, 1 është në servis dhe nuk kemi të tjera. Dua të shfrytëzoj rastin pasi që është këtu edhe përfaqësuesi i KLSP në Orllan, meqë edhe nesër është takimi i këtij këshilli, se nuk do të mundemi të funksionalizojmë Nënstacionin policor sipas strukturës së re organizative. Kjo ishte sa i përket raportit, vetëm dua të shtoj se në asnjë vit nuk kemi qenë më mirë me statistika të rasteve se sa këtë vit. Na gëzon fakti se raste të vjedhjeve dhe të vjedhjeve të rënda kemi më pak se çdo vit por për këtë do të njoftoheni me raport përfundimtar në fund të vitit. Mendoj se është e nevojshme që Kryetari i Komunës të zhvillojë takim me Ministrin e

Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me çështjen e trafikut që në Komunë të jetë policia komunale, pra të jetë një njësi e trafikut të merret me trafikun në Podujevë, sepse fjala vjen neve na ndodh një aksident me lëndime në fshatin Pollatë apo diku tjetër ndërsa Njësia e Trafikut ndodhë të jetë e angazhuar në një rajon të Komunës së Drenasit. Në këtë fushë nuk ka efektivitet, nuk po bëhet menaxhimi si duhet. Duhet të jetë një njësi e trafikut si strukturë e veçantë, sepse përndryshe deri sa të arrijnë zyrtarët e trafikut po bllokohet trafiku dhe po krijohen kolona të mëdha të automjeteve. Për një rast mesatarisht kanë kaluar 2 orë e 36 minuta nga fillimi deri në përfundimin e një rasti. Ne si Polici matemi dhe vlerësohemi me statistika, andaj kjo kohë e kaluar duhet të zbritet. Problem gjithashtu është mbulimi i territorit pasi është shumë i gjerë.

z. Bahri Selimi, falënderojmë Komandantin për informatën e paraqitur. Sa i përket kërkesës për angazhimin e një njësie profesionale të trafikut, mendoj se duhet shikuar legjislacionin se a parashihet një mundësi të tillë, por mendoj se Kryetari do të konsultohet me Ministrin dhe nëse ekziston mundësia jemi për angazhim e një njësie të trafikut sepse edhe ne jemi duke parë gjendjen. Me keqardhje dëgjova informatën se një numër i zyrtarëve policor kanë dhënë dorëheqje dhe kanë shkuar dhe jam i interesuar të dijë se cila është arsyeja e kësaj sepse kohën e fundit shkuarja nga vendi ka marr jehonë. Jemi në dijeni se të rinjtë me padurim presin të bëhen pjesëtar të policisë së Kosovës dhe në fund ta dorëzojnë uniformën, kjo me të vërtetë është shqetësuese. Shqetësuese ishte edhe çështja e logjistikës në Polici, përkatësisht mungesës së automjeteve, për çka në një mënyrë jemi të njoftuar për këtë çështje. Në këto mundësi që kemi do të shohim që të mbështesim policinë me ndonjë automjet për ndonjë rast. Nga ana tjetër po ndihemi mirë pasi që gjendja e sigurisë vlerësohet më mirë se sa vitet paraprake. Unë e hap diskutimin lidhur me informatën e paraqitur nga Komandanti i Stacionit të Policisë.

z. Shemsi Jashari, theksoi, fillimisht dua t'i shprehë ngushëllime kolegut për një koleg të tij i cili kishte ndërruar jetë para disa ditësh i cili ka qenë edhe ish koleg i imi. Ajo që dëgjuam nga Komandanti në raportimin e tij është bukur shqetësuese. Është mirë që statistikat flasin për një rënie të rasteve por është keq që kjo nuk është meritë e shtimit të kapaciteteve ose të një angazhimi të theksuar për të arritur sigurinë, por është një sjellje e qytetarëve që këto statistika të jenë në këtë nivel. Nga takimi i fundit kemi parë bukur shumë zhvillime e që në aspektin e sigurisë janë shqetësuese ku mund të veçojmë disa tentativave që kanë të bëjnë me aspektin e religjionit. Shpërfaqja e disa grupeve dhe organizatave që bëjnë thirrje për dalje prej një feje të caktuar dhe për të themelua fe të reja, e disa tjerë të një grupi në një kishë në rajonin e Orllanit, e që shqetësuese dhe më e pa mençur ka qenë pjesëmarrje e zyrtarëve të Komunës edhe pse është dhënë sqarimi se nuk ka qenë në emër të komunës por sido që të jetë zyrtarët shpesh janë duke harruar se prezenca e tyre përfaqëson, e që nuk do të duhej që puna të vijë deri në atë situatë. Këtu reagimi i Komunës ka qenë bukur vonë. Jemi në dijeni se për momentin kjo është nën kontroll. Pyetja është se a dihet gjeneza dhe kush qëndron prapa këtyre lëvizjeve që duken se nuk janë krejt të rastësishme. Jam në dijeni se nuk janë shtetas të Kosovës ata që i kanë pri asaj ceremonie në atë kishë dhe duket diçka më shumë se rastësi. Në aspektin e sigurisë momentalisht mund të themi se është qetë, por duke ditur që Komuna e Podujevës ka qenë njëra ndër komunat më të qeta në kuptimin e veprimeve ekstremeve që janë shpërfaq në nivel vendi, mund të thuhet se Komuna e Podujevës është kthyer në njërën prej adresave ku mund të shpërfaqen edhe probleme që ndërlidhen me këto situata të rrezikshme por edhe shqetësuese, sepse nëse diçka është shpërfaqë në Komunën e Podujevës kam pas rast të marr pjesë në bukur shumë takime që është fol rreth tolerancës dhe aspektit religjioz, Komuna e Podujevës është marr model për një tolerancë, për një të

menaxhimit të situatave që kanë pas background-in e aspektit religjioz. Sa i përket mungesës së kapaciteteve njerëzore të Stacionit Policor Podujevë, prej që jam anëtar i këtij Këshilli, thuhet se dy vite vazhdimisht është shpërfaqë mungesa e zyrtarëve, mungesa logjistike, e tashmë kohën e fundit edhe trendi i braktisjes së vendit të punës-dhënia e dorëheqjeve. Duke parë këtë pa përgjegjësi në menaxhim nga Niveli qendror, dhe një retorikë bukur ofenduese ndaj zyrtarëve policor që vjen prej vet Ministrisë nuk pres që do të ketë zgjidhje ose mbështetje më shumë në këtë drejtim, e që do të duhej ti kushtoj rëndësi shumë më shumë nga institucionet relevante.

Themelimi i KLSP-ve në nivel lokal, biseda me akterë, një proces i cili kishte për ti ndihmuar këtij procesi edhe në aspekt të sigurisë. Themelimi i këshillave lokale është një proces i cili është bllokuar nga Komuna dhe nuk janë duke vazhduar për ta përfunduar. Mesazhi i imi është që Komuna e Podujevës nuk duhet të qëndroj si spektator. Themelimi i këshillave lokale si proces duhet shtyrë përpara. Pyetje për Komandantin, a është mundësia për të ditur se sa keni mungesë të stafit në raport me strukturën, sepse jam në dijeni se është ngritur niveli i Stacionit Policor të Komunës së Podujevës.

z. Nuhi Selimi, theksoi, po ndërlidhem me rastin që ndodhi te kisha në fshatin Rakinicë. Nënvizoi, nuk mund të thuhet se nuk mbajmë faj lidhur me këtë, duke filluar nga AKI e deri te organet komunale relevante, për faktin se ngjarja ka ndodhur gjatë ditës dhe në mënyrë të qetë, nga persona për të cilët nuk kemi pas njohuri se nga vijnë, por që i kanë shoqërua dhe përkrahur persona të pushtetit dhe kjo është shqetësuese për mua. Ky rast i ka shqetësuar disa familje dhe si rast ishte për ne me efekt negativ dhe në interes të dikujt tjetër, jo neve. Kisha kërkuar nga Kryetari i Komunës dhe institucionet relevante të kuptojnë se nga ka rrjedh kjo dhe nga ka ardhur dhe pse është përkrahur prej njerëzve tanë. Tentime të tilla ka pas edhe përpara por si kemi lejuar, për këtë janë të njoftuara edhe organet e sigurisë. Ku keni parë sikur tash të vjen një organizatë joqeveritare dhe kërkon një autorizim për të mbajtur një orë me nxënës, por gjithherë kemi praktikuar ku u kemi thënë për këtë të marrin leje apo vendimin nga Drejtoria e Arsimit e cila është përgjegjëse që të lejojë, përndryshe nuk u kemi dhënë qasje. Edhe kjo, mendoj se Komuna është dashur të përcjell këtë sepse ka institucione komunale dhe është dashur të dijë, se kush kon po e përfaqëson në aspektin fetar, apo fshatin. Janë disa gjëra që mua më duken shqetësuese ngase po bëhen gjëra e askush nuk është duke ndërmarrë asgjë. Çfarë duhet t'i bëjmë asaj familje në fshatin Rakinicë e cila është e shqetësuar. Sa i përket stafit policor ai nuk ka nevojë të qëndroj vetëm për të ruajtur objektin. Për këtë jemi në dijeni edhe sa i përket përgjegjëseve për këtë punë, pra faji është nga lartë.

z. Bahri Selimi, para se t'ia kalojmë fjalën komandantit të Stacionit Policor, vetëm desha të theksoj se sipas informatave tona pushteti komunal nuk ka përkrahë atë iniciativë në fshatin Rakinicë. Individit që ka qenë prezent edhe pse punëtor i Komunës nuk përfaqëson institucionet. Pra atje kanë qenë individë dhe Komuna nuk është insituitucion që mundet të ushtrojë kontrole ndaj tyre, pra pjesëmarrja e individëve nuk përfaqëson Komunën. Sikurse jeni në dijeni personi në fjalë është banor i atij fshati sepse ka lindur në atë fshat. Komuna nuk ka qenë në dijeni se çfarë po ndodhë atje dhe nuk kemi ditur qëllimin e tyre. Komuna nuk përkrah iniciativa që nuk lidhen me interesin e Komunës. Edhe njëherë e përsëris se përfaqësimet bëhen prej institucioneve dhe jo individëve dhe shpresojmë se do të përmbillet kjo çështje.

z. Shamsi Jashari, besimi dhe përcaktimi në një fe të caktuar absolutisht është e garantuar dhe nuk kam parë se dikush ka diçka kundër atyre që i takojnë një komuniteti fetar. Nuk ka të bëjë kjo me atë që dikush beson në një fe tjetër, pra nuk ka të bëjë çështja e besimit. Forma, mënyra, tendenca, prapavija e atyre organizimeve që mund të

ngjallë urrejtje brenda fetare, këtu është problemi. Edhe në rastin atje, nëse ka familje që një në mënyrë ndihen të rrezikuar sikurse dëgjuam përfaqësuesin që vjen prej asaj zone, mendoj se institucionet e kanë për obligim për të komunikuar me ata banorë për tu sqaruar dhe sigurua se ku ka qenë tendenca, që mos të vie si shkas që një organizim i tillë të mos ndikojë në prishjen e harmonisë dhe bashkëjetesës të atyre familjeve me pjesën tjetër të komunitetit. Ky rajon shquhet për tolerancë dhe për bashkëjetesë pa pasur asnjëherë probleme të kësaj natyre. Pra shqetësimi që ka të bëjë me sigurinë është këtu. Ka ndodhë diçka dhe si ka ndodhë, besoj se organet e sigurisë kanë vlerësimet e veta, por tash çfarë ne duhet të bëjmë për të pasur më shumë komunikime dhe për tu siguruar se ngjarje të tilla nuk do të përshkallëzojnë situatën në atë pjesë.

z. Nijazi Jashari, dua të theksoj se lidhur me rastin e cekur kemi qenë vazhdimisht të angazhuar edhe me shefin e hetimeve. Sipas strukturës së re organizative të ne duhet të jenë 117 zyrtar policor të uniformuar, e që unë personalisht nuk jam i kënaqur me këtë shifër se nuk kanë marrë parasysh territorin. 105 zyrtar policor i kemi të uniformuar, 10 staf civil, 9 zyrtar pre numrit 105 kanë kufizime në angazhime, pra me dy zyrtar nuk mund të bësh një patrullë dhe kjo është gjendja momentale. E përsëris, nuk jam i kënaqur me këtë numër që duhet të jenë 117, ku duhet mbuluar edhe Nënstacionin policor të Orllanit. Te çështja e shtruar, iniciativa për ndërrimin e religjionit kemi informacione, por nuk kemi parë diçka se duhet intervenuar sepse nuk ka pas deri tash ndonjë element që neve na involvon, sepse atë aktivitet e kanë bërë haptas dhe e kanë publikuar. Dihet kush është kryetar i kësaj Iniciative dhe kush janë anëtarë të kryesisë, të cilët para një kohe kanë mbajtur takim edhe në Mazgit në një restorant ku kanë zgjedh dy udhëheqësi. Deri sa tjetrit nuk i cenohen të drejtat ne nuk intervenojmë. Po thuajse është çështje e njëjtë edhe ajo te kisha në fshatin Rakinicë. Tendanca të njëjta ka pasur edhe vitin e kaluar prej një grupi tjetër por nuk i kemi lejuar. Këtë vit kemi kuptuar për ngjarjen atëherë kur ka përfunduar. Ka qenë një grup në krye me një at Nikolë Xhufa nga Elbasani prej një kishe ortodokse shqiptare dhe ai ka hyrë brenda sepse dera nuk ka qenë e mbyllur me qelës, pra kanë hyrë e kanë bërë një meshë dhe kanë kryer ceremonitë fetare, dhe kjo ka qenë e publikuar edhe në media. Ne si autoritet kemi pasur takim me z. Nikolë më vonë së bashku me shefin e inteligjencës, ku kemi biseduar dhe iu kemi sqaruar disa gjëra. E mira e tërë kësaj që ka ndodhur është se nuk ka pasur dhunë, dëmtime apo thyerje. Ne e kemi përfunduar dhe dërguar Raportin lidhur me çështjen. Mund të them se asnjë zyrtar komunal në cilësi zyrtare nuk ka marr pjesë aty, por kanë qenë në cilësi private. Në ndërkohë kanë ardhur përfaqësues të kishës ortodokse serbe ku kemi mbajtur takim me ta, ku ishin të pranishëm edhe karabinierët italian, përfaqësues të OSCE. Përfaqësuesit e kishës ortodokse serbe kanë mbajtur një meshë në kishë. Kemi pasur takime me përfaqësuesin ligjor të autorizuar nga kisha ortodokse i cili ka kërkuar të hapim rast, por në konsultim me prokurorin është konstatuar se nuk ka elemente për rast kriminal sepse meshat apo takimet aty janë zhvilluar ndaras në periudha kohore. Kisha është në gjendjen siç ka qenë. Ne jemi duke mbajtur në kontroll situatën, jemi në kontakt të vazhdueshëm me atë banorin afër kishës atje. Deri më tani nuk ka kurrfarë kërcënimesh apo paraqitje rreziku. Kisha për momentin është e mbyllur me dry nga ana e kishës ortodokse serbe. Ai është objekt që është në menaxhim të Ministrisë së Kulturës, e mbrojtur si trashëgimi kulturore dhe Komuna këtu s'ka fare të bëjë. Prej OSCE, Stacioni Policor Podujevë ka marrë një mirënjohje me shkrim për menaxhim të kësaj ngjarjeje. Kjo ishte në pika të shkurtra.

z. Liman Zeqiri, theksoi, ne si komb dhe shqiptarë që jetojmë këtu jemi në dijeni për periudhat tona kombëtare dhe nuk dua të thellohem në atë sepse bota është ndarë në

blloqe dhe kjo është rrezikshmëria më e madhe e planetit. Ne si shqiptarë dhe si komunitet kemi kaluar nëpër perioda të rënda në kuptimin ideologjik apo fetar. Konkensionet neve na kanë degraduar në kuptimin e etapave kohore, shqiptarët më së pari kanë qenë ortodoks, e pastaj si rezultat i pushtimeve normale që shumica absolute ka pranuar besimin mysliman. Por vlen të theksohet se shqiptarët kurrë njëherë nuk kanë pasur konflikt ndërjetar dhe kjo është pasuria më e madhe ku i kemi treguar edhe botës se ne nuk kemi divergjenca sepse bindja është bindje, liria është liri dhe krejt popujt në botë luftojnë për liri. Bota perëndimore ka lirinë demokracinë dhe fjalën e lirë, ndërsa blloku tjetër ka diktaturë dhe dihet ku përfundon dhe ne nuk jemi në krahun e lindjes, bllok i cili tenton në ngritjen e nacionalizmit dhe urrejtjes ndërjetare. Sikurse e theksuan edhe parafolësit është e drejtë e çdo njeriu që të mendon i lirë, si e drejtë e njerëzimit, prandaj duke u nisur nga kjo ne i kemi përqaftuar dhe i pranojmë të gjitha mendimet tjera. Si njeri duhet të jetojmë të lirë dhe duhet shprehur mendimin lirshëm. Ne nuk bën të kalojmë në kuptimin e asaj që feja apo religjioni të kalojnë në ekstremitet, sepse ekstremi është urrejtje e urrejtje shqiptarët nuk kanë pasur. Unë i përkrah mendimet e lira dhe nuk mund të futet diçka te ne që do të mund të na krijojë divergjencë sepse ne i kemi tejkaluar këto dhe do ti tejkalojmë.

Përfaqësuesi i KFOR-it, gjendja e sigurisë në Komunën e Podujevës vlerësohet e qetë nga perspektiva e KFOR-it dhe falënderojmë për bashkëpunimin. Kjo ishte e tëra sa i përket KFOR-it.

z. Bahri Selimi, falënderojmë përfaqësuesin e KFOR-it për informatën, pasi që përfaqësuesja e FSK-së nuk është prezentë kalojmë në pikën e radhës.

3. Informatë për rastet e ngritjes së shkallës së gatishmërisë në situatat emergjente

z. Bahri Selimi, theksoi, referuar nga fushëveprimi i DSHPMSh, unë do të paraqes informatën. Sa i përket shkallës së gatishmërisë ne si autoritet komunal i kemi zhvilluar të gjitha procedurat ligjore për ngritjen e shkallës së gatishmërisë. Për vet faktin që flitet për raste emergjente bën të nënkuptojë se kujdesemi për rastet emergjente kryesisht që vijnë prej fatkeqësive natyrore. Në fillim të vitit kemi ngritur Shtabin Emergjent për Mbrotjtje dhe Shpëtim ku janë të përfaqësuar të gjitha organet që kanë të bëjnë me sigurinë nga raste emergjente. Sikurse jeni në dijeni kohën e fundit jemi përballë shumë me vërshime ku edhe qenë shkaku kryesor i ngritjes së Shtabit. Fatmirësisht nuk kemi pas raste të tërmeteve që mund të jenë edhe më fatale. Koordinimi i Shtabit me Njësinë e Zjarrfikësve, me Policinë e Kosovës dhe institucionet tjera relevante ka qenë shumë funksional. E kemi diskutuar edhe më herët se nuk janë në pozitën se si do të duhej të ishin zjarrfikësit në Komunën tonë dhe kjo jo si shkaktar komuna apo vet Njësia por për shkak të një institucioni i cili ka lënë përzierje të kompetencave. Në këtë rast kemi të bëjmë me AME-në autoritet i cili ka kontrollin kryesor mbi Njësinë e Zjarrfikësve, ndërsa Komuna bën plotësimin e kushteve logjistike dhe pagesat. Kemi bërë shumë herë kërkesa në AME për rritjen e numrit të zjarrfikësve. Njësia ka 14 zjarrfikës, ndërsa në bazë të ligjit përkatës duhet të ketë 59, sepse për çdo 1500 banor kërkohet të jetë një zjarrfikës. Nga vet numri bën të nënkuptohet se nuk është gjendja mirë te Njësia. Zjarrfikësit me punën që e kryejnë janë shumë profesional dhe nuk kam asnjë vërejtje lidhur me kohën në rastet e dërgimit të tyre në terren. Çdo kërkesë e qytetarëve që vie, drejtohet përmes neve në Shërbimin e Zjarrfikësve, çoftë për vërshime, zjarre, fatkeqësitë e ndryshe, komunikacion etj. Edhe pse Shërbimi nuk ka logjistikë të mjaftueshme, ku në rend të parë ka mungesë të një kamioni të zjarrfikësve me shkallë, kanë kryer punën

jashtëzakonisht mirë. Në takimet e fundit që kemi pas me zyrtarë të AME-së, kemi marrë konfirmimin se në vitin 2024 kanë ndarë një buxhet për pajisjen e Njësisë së Zjarrfikësve në Komunën e Podujevës me një kamion me shkallë i cili do u ndihmojë shumë në intervenime në objekte banesore të larta. Janë nisur disa procedura për qartësimin e kompetencave ligjore ndaj Njësisë së Zjarrfikësve. Ne kemi marr një kërkesë prej qytetarëve për formimin e një shoqate vullnetare të zjarrfikësve e cila do të na ndihmonte shumë me punën e tyre, edhe pse nuk jam në dijeni se deri ku ka arritur me procedura, sepse sipas tyre kanë aplikuar në Ministri përkatëse për marrje të licencës. Kjo do të ishte ndihmesë sepse shoqatat e zjarrfikësve thuhet ekzistojnë në tërë botën. Çështje tjetër kemi Planin Operativ Emergjent, si dokument i cili ka kaluar të gjitha procedurat dhe do të procedohet për miratim në mbledhjen e radhës së Kuvendit. Kemi përgatitur Planin e Veprimit i cili rezulton si pjesë e Planit Operativ Emergjent, por njëkohësisht kemi përgatitur edhe draft Planin për Vlerësimin e Rreziqeve i cili do të kalojë të gjitha procedurat për miratim. Planin Operativ emergjent i parasheh të gjitha këto, por përmes këtyre planeve tjera jemi munduar ta zgjerojmë. Krahas kësaj kemi punuar në zgjerimin e rrjetit të kamerave të sigurisë dhe këtë vit kemi lidhur kontratë me një operator ekonomik, ku i kemi riparuar dhe funksionalizuar mbi 70 kamera të vendosura dhe kemi vendos edhe 9 kamera të reja e që aktualisht numri i kamerave të vendosura është mbi 80. Ka nevojë për më shumë kamera të sigurisë, por edhe për këtë vit kemi planifikuar buxhet për ta zgjeruar edhe më tej rrjetin, e që prioritet i kemi dhënë pjesës kufitare. Sa për informim kamerat e sigurisë i kontrollon vetëm Policia, ndërsa ne i mirëmbajmë dhe i rregullojmë. Kjo ishte në pika të shkurtra se çka ne si Komunë kemi bërë për ngritjen e shkallës së gatishmërisë në raste emergjente. Lidhur me këtë temë e hap diskutimin.

z. Qefser Behrami, theksoi, kam një kërkesë, në fshatin Metehi e kemi një mulli të ujit mbi 300 vite i ndërtuar dhe gjatë kohës së luftës së fundit ka qenë në shërbim të një numri jashtëzakonisht të madh të popullatës e zhvendosur në atë pjesë. Falënderojmë Hortikulturën për ndërhyrje në atë mulli. Desha të them se kemi një problem të madh për shkak të pendave të ndërtuara në atë pjesë e cila është një pengesë shumë e madhe ku ka bërë dëme edhe në sektorin e bujqësisë por edhe te mullirit. Këtë e kam potencuar edhe njëherë por ende nuk është ndërmarrë diçka. Penda në atë pjesë është e bllokuar prej mbeturinave për shkak të hedhurinave. Nëse ajo pendë nuk rregullohet në këtë fazë priten vërshime të mëdha dhe do të shkaktojë dëme të mëdha në atë tokë pjellore.

z. Nuhi Selimi, theksoi, u përmendën kamerat e sigurisë, vetëm desha të dijë se a është paraparë ndonjë në fshatin Orllan, sepse ka jashtëzakonisht shumë nevojë. Nëse nuk keni paraparë, kërkesa është të vendosen edhe në atë pjesë.

z. Qefser Behrami, theksoi, gjithashtu edhe unë kam një kërkesë, kam kërkuar vendosjen e pengesave në rrugë, por edhe vendosje të kamerave të sigurisë në pjesën tonë, duke marrë parasysh ngarkesën e asaj rruge e cila lidhet edhe me Mitrovicën.

z. Liman Zeqiri, theksoi, dua të shtoj diçka rreth zjarrfikësve. Ka qe 23 vite pas lufte dhe kurrë njëherë nuk jemi marrë me këtë Njësi e cila ka një rol specifik, sepse drejtpërdrejtë merren me shpëtimin e jetës dhe ambientit. Ajo që mua më shqetëson është numri shumë i vogël i zjarrfikësve, e që do të duhej marr përbazë faktorin demografik. Komuna jonë ka 78 fshatra, si dhe qytetin dhe ka afërsisht 90,000 banorë. Dhe kur ne i supozohemi kësaj ai numër i zjarrfikësve është shumë i vogël dhe punojnë 24 orë dhe shteti si shtet është dashtë bëjë më shumë për zjarrfikësit, sepse ata janë njësi i parë që dalin në vendngjarje për të reaguar. Unë kisha kërkuar që ju si Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit a ka mundësi të parashtrimit të ndonjë kërkesë në kuptimin shtetëror për rritjen e numrit të zjarrfikësve dhe krijimin e kushteve qoftë me

teknikë dhe pajisje. Sa i përket shoqatës, ato janë shoqata dhe kanë interesat e veta dhe pse kanë shprehur vullnetin për të ndihmuar në mënyrë vullnetare, por institucionet e kryejnë punën e vet sepse janë të obliguar në kuptimin institucional.

z. Shemsi Jashari, theksoi, nga raportimi i Drejtorit të DSHPMSH që ka të bëjë me ngritjen e shkallës së gatishmërisë ishte çështja rreth Planit të Reagimit Emergjent, do të thotë nuk pash asnjë aktivitet tjetër që ka bërë Komuna në këtë drejtim. Te rasti i vërshimeve keni qar një komision, por çka konkret ka bërë Komuna në këtë drejtim, u pa që Njësi i zjarrfikësve nuk është kompetencë e juaja dhe nuk mund të bëni më shumë dhe u konstatuan problemet për te cilat jemi të gjithë në dijeni, por si Komunë duhet bërë shumë më shumë. Ne e kemi pas një plan pune e që për fat të keq nuk është realizua, ndërsa për Planin e Reagimit Emergjent sikurse jeni në dijeni në çdo mbledhje i shihni edhe procesverbalet ka qenë një kërkesë për të mos thënë një presion pozitiv për ta shtyrë përpara por që ende nuk ka përfunduar dhe ne nuk e kemi ende në formatin PDF as në Word atë dokument. Ka qenë premtim i yti dhe besoj se është edhe pjesë e procesverbalit që ke për të na dërguar dokumentin e kurrë nuk na ka arritur, e që është dashur të na trajtoni si anëtarë dhe pjesë të ekipit dhe për asgjë tjetër si qytetarë kemi të drejtë t'i kemi. Unë po besoj se do të mund të kontribuonim diçka në atë drejtim, por s'kemi dhënë asgjë për shkak se nuk kemi pranuar dokumentin. Por nëse neve na trajtoni thjesht si qytetarë sigurisht se do ta shikojmë edhe ne sikurse e bëjnë të tjerët. Në plan të punës kemi pas detyra; -Vlerësimi i mjedisit publik nga aspekti i sigurisë, ku është menduar të mbahet një punëtori për ti trajtuar problemet kyçe, nuk është mbajtur; - Hartimi i listës së prioritetëve për investime dhe adresimi në Projektbuxhetin e vitit 2024, nuk është mbajtur; -Një vlerësim i listës së investimeve publike nga këndi i elementeve të sigurisë ,nuk është mbajtur; -Vlerësimi i shërbimeve publike nga këndi i sigurisë publike, nuk është mbajtur; -Hartimi i Planit të Reagimit Emergjent, është në procedurë dhe shpresojmë se do të miratohet;- Testimi i reagimit në raste emergjente, të gjitha agjencitë duhej të simulonin një rast për të ditur se ku janë me kohën e reagimeve në raste emergjente, sikurse e theksoi Komandanti i Policisë i cili theksoi se e dimë saktë sa na duhet kohë për të reaguar në rast të një aksidenti, për shkak se institucioni duhet të dijë kapacitetet e veta dhe kohën e reagimit dhe një punëtori ka qenë e planifikuar mes akterëve institucional dhe publik. Nga Plani punës së KKS-së vetëm një është në procedurë për tu përfunduar dhe pritet deri në fund të muajit dhjetor për tu miratuar në Kuvend. Kur flasim për këtë pikë të rendit të ditës dhe për të ngritur shkallën e gatishmërisë, mendoj se të gjithë këta hapa është dashur të merren për të nxjerrë më të mirën të mundshme, veprimet e duhura dhe për të reflektuar në planifikim si të buxhetit ashtu edhe të projekteve për vitin 2024, në funksion të lehtësimit të qasjes ndaj problemeve. Atë që unë kam parë është një tendencë për të konstatuar problemet më shumë sesa për të dhënë zgjidhje për to dhe këtu është defekti. Konstatimi i gjendjes ju ndihmon vetëm për të planifikuar aktivitetet, e jo për të pas ankesa, cili është veprimi konkret. Përveç Planit të Reagimit Emergjent cila është puna konkrete që Komuna e ka bërë për të përmirësuar aspektin e sigurisë në Komunë.

z. Bahri Selimi, theksoi, penda e ndërtuar për ujitje është një projekt i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe është e vërtetë se ka shkaktuar probleme sepse edhe vet kam qenë në vend të ngjarjes aty. Rreth kësaj jemi në një situatë të palakmueshme, sepse nuk është edhe vetmja ajo pendë që ka shkaktuar, këtë e them në kuptimin që ti largojmë ato penda apo të vazhdojnë të mbesin edhe pse ka qenë kërkesë e banorëve për ngritjen e pendave për ujitje. Për mirëmbajtjen e tyre kemi menduar ta ndajmë një buxhet të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural sepse kjo

Drejtori merret edhe konkretisht me to, sepse janë edhe projekte të saj. Lidhur me këtë një vendim duhet ta marrim sepse edhe ashtu ishte kërkesë e juaja. Mirëmbajtja e pendave është bukur e vështirë duke marrë parasysh faktin se grumbullohen mbeturina dhe mbyllet dhe që është dëmtuar shumë sistemi i hapjes dhe i mbylljes së tyre, megjithatë ne duhet bërë një zgjidhje. Për dëmet e shkaktuara ne kemi bërë një kërkesë për një buxhet shtesë nga Ministria e Planifikimit Hapësinorë dhe Mbrojtjes së Mjedisit ku na është aprovuar një buxhet i cili do të fillojë nga viti i ardhshëm dhe do të vazhdoj për dy vitet tjera, duke i bashkëngjitur edhe mjetet e ndara nga buxheti i Komunës ku dhe besoj se do të bëhet një zgjidhje e dëmeve të shkaktuara nga lumenjtë. Dua të them se shtretërit e lumenjve do të rregullohen dhe zgjerohen në tërësi, në vendet ku janë më të ndjeshme. Sa i përket interesimit për vendosjen e kamerave të sigurisë në fshatin Orllan, sa dua të theksoj se prioritet kemi mbulimin e qytetit me kamera të sigurisë duke pas parasysh frekuentim e madh të qytetarëve. Në koordinim dhe bashkëpunim me Policinë kemi bërë një planifikim për vendosjen e tyre. Për tani nuk ka ndonjë planifikim për fshatin Orllan por nuk do të thotë se nuk do të futet në proces nëse ka ndonjë rekomandim nga Policia dhe vërtetohet si zonë e rëndësishme ku parashihet nevoja për vendosje të kamerave. Për vitin e ardhshëm Policia do të na sugjeroj vendet për vendosje të kamerave. Kur jemi te Njësia e Zjarrfikësve ne kemi bërë kërkesa të vazhdueshme Autoritetit qendror për nevojën e rritjes së numrit të zjarrfikësve. Lidhur me përcaktimin e kompetenca sa i përket stafit kompetent është AME-ja, ndërsa Komuna përmbush obligimet në aspektin financiar. Tani kjo forma e ndarjes së buxhetit dhe përshtatshmërisë së stafit me buxhet është problematike gjë që ka reflektuar se as AME nuk ka pasur mundësi të zhvillojë procedura të rekrutimit të stafit. Aktualisht nga ana e AME-së është një iniciativë dhe pritet që zjarrfikësit të kalojnë në kompetencë të AME-së. Zjarrfikësve çdo muaj i bëjmë pagesën e orëve shtesë në kuadër të autorizimeve ligjore. Në çdo intervenim që kanë jashtë orarit të punës ne ju kompensojmë edhe shujtat. Kjo ishte ajo çka ne mundemi të bëjmë për shërbimin e zjarrfikësve. Te çështja e ngritjes së shkallës së gatishmërisë e kam parasysh se Plani i KKSB-së nuk është zbatuar në tërësi por ky është plan dhe nuk nënkupton se duhet zbatuar 100%, e që do të ishte mirë. Për identifikimin e problemit dhe ndërmarrjen e hapave besoj se çdo problem të identifikuar, kemi ndërmarrë veprime procedurale dhe hapa konkret. Shkaktarë i të gjitha këtyre çështjeve është buxheti i pa mjaftuar. Te simulimet e aksidenteve dhe rasteve emergjente pajtoj plotësisht se është shumë efikase për të bërë një simulim për të parë kohën e veprimit të institucioneve komunale. Sikurse e përmendi Komandanti kohën e kaluar në vend ngjarje edhe Njësia e Zjarrfikësve është në gjendje të perceptoj kohën saktë e arritjes për të intervenuar, prej marrjes së informatës. Shpresoj se këtë do ta bëjmë në të ardhmen edhe pse jemi në dijeni se kërkon përkushtim dhe punë në këtë drejtim. Për të gjitha çështjet tjera të natyrës së sigurisë kemi ndërmarr veprime dhe atë së bashku me institucionet relevante. Sa i përket draft Planit Operativ Emergjent që nuk u është përcjell në formatin word, komisioni përkatës i hartimit të dokumentit ka theksuar se drafti nuk lejohet të procedohet në formatin word, përndryshe drafti i dokumentit është publik në formatin PDF dhe ka qenë i qasshëm për të gjithë. Në ditën e dëgjimit publik për dokumentin e cekur edhe përkundër publikimit të njoftimit për ditën e mbajtjes nuk ka marr pjesë askush. Unë kam bërë kërkesë juve si anëtar të KKSB-së për të marr pjesë por edhe anëtarëve të Kuvendit. Për atë draft plan janë mbajtur 5 workshope në bashkëpunim me UNDP-në, AME-në dhe Kryqin e Kuq dhe ai dokument është proceduar në Kuvend.

z. Qefser Behrami, theksoi, kur është çështja e pendës, ajo është e dedikuar për mullirin dhe jo për ujitje dhe ajo tokë që është e dëmtuar nuk ujitet nga ajo pendë.

z. Bahri Selimi, theksoi, lidhur me diskutimin e parafolësit do të ndërmarrim hapa në atë aspekt sido që të jetë.

z. Liman Zeqiri, theksoi, në vitin 2003 një delegacion i Komunës së Podujevës ka qëndruar në Qeki dhe është bërë projekti më i madh i asaj kohe për menaxhimin e ujërave të zeza, por nuk jam në dijeni se ku është ai projekt. Lumenjtë janë degraduar dhe nuk jeni fajtor. Në pyetje është ambienti dhe largimi i ujërave të zeza është problemi më i madh te ne. Të gjitha ujërat e zaza derdhen në lumenj. Shtrohet pyetja se sa është punuar për menaxhimin e ujërave të zeza. Është kriter dhe nuk mundemi të hyjmë në BE pa mirëmbajtje të ambientit dhe menaxhimin e ujërave të zeza. Menaxhimi i ujërave të zeza është problemi më i madh në Komunën tonë.

z. Bahri Selimi, theksoi, nëse nuk ka dikush diçka tjetër për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

4. Formimi i Grupit punues për përgatitjen e Planit të Punës 2024

Formimi i Grupit punues për përgatitjen e Informatës për punën e KKSB për 2023

z. Bahri Selimi, theksoi, vitin e kaluar kemi ngritur grupin punues për përgatitjen e këtyre dy materialeve, të shohim a do të vazhdoj i njëjti grup apo të dalim me propozime tjera.

z. Shemsi Jashari, sa i përket grupit punues propozoj të mbetet me përbërjen e njëjtë me ndryshim që unë mos të jem koordinator i grupit, sepse është viti i tretë që kam përgjegjësi të udhëheq këtë grup punues, por po shihet se aktivitetet nuk po implementohen dhe këtu çështja është se unë ose nuk po di të përgatis planin ose ju nuk po e implementoni, kështu që unë do propozoja që ju ta drejtoni këtë grup për ta përgatitur planin dhe do ta dini saktë se çka mund të realizoni a çka jo, përndryshe kur të bëhet vlerësimi i rezultatit të punës së KKSB-së dhe rezulton se prej 7 aktiviteteve të planifikuara vetëm një kryhet dalim keq si KKSB, kështu që unë nuk dua të vazhdoj në cilësinë e kryesuesit të grupit punues.

z. Bahri Selimi, theksoi, besoj se në çështjen e hartimit të Planit të punës unë më shumë do të jap kontributin si anëtar i KKSB-së, sepse drafti edhe ashtu është rezultat i punës së grupit së bashku, kështu që nuk mund të marrë përsipër udhëheqjen e grupit për shkak të punëve dhe angazhimeve tjera që kam, por nëse mendoni që grupi të jetë i njëjti ai edhe do të bëj zgjedhjen e kryesuesit.

z. Shemsi Jashari, theksoi, desha të jem i sinqertë, nuk po ndihem mirë pasi që është viti i dytë e ky plan nuk realizohet fare dhe arsyet të interpretohen nga secili prej këndit të vet, kështu që unë nuk dua të jem udhëheqës i grupit, si anëtar do të jap kontributin.

z. Nijazi Jashari, theksoi, koordinator të grupit punues propozojë të jetë z. Liman Zeqiri.

z. Liman Zeqiri, theksoi, fjala sinqeritet është më e mira në jetë. E kuptova z. Shemsi Jasharin, dy vite shumë e tha. Duhet ta pranojmë realitetin se realiteti për dikë është dhimbje por është e vërtetë, sepse jemi për qytetarët, nuk jemi për veti këtu. Shtatë takime, shtatë veprime, shtatë punë dhe vetëm një e realizuar, z. Jashari ka drejtë dhe plotësisht jam i pajtimt me atë që theksoi. As unë nuk mund të marrë këtë grup për ta udhëhequr, se nuk dua të jem servil e të dorëzohem para askujt. Unë e falënderoj z. Shemsi Jashari për kontributin e tij. Unë gjithashtu propozojë që ti të jesh udhëheqës i grupit.

z. Bahri Selimi, unë e theksova më herët se nuk mund të jem udhëheqës i grupit për shkak të punëve dhe angazhimeve që kam, por unë propozojë z. Avni Fetahu që të jetë kryesues i grupit, besoj se i përmenduri do të kryej këtë punë.

Konstatim

Pas procesit të votimit z. Bahri Selimi konfirmoi ngritjen e Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së KKSBS-së për vitin 2024 dhe për përgatitjen e Informatës për punën e KKSBS për 2023, në këtë përbërje:

z.Nijazi Jashari
z.Mensur Hoti
z.Shemsi Jashari
z.Shefki Selmani
z.Xhafer Ademi
z.Sevdije Mustafa
z.Bahri Selimi
z.Qefser Behrami

Ndërsa në cilësinë e koordinatorit të Grupit punues caktohet Avni Fetahu.

5. Të ndryshme

z. Bahri Selimi, theksoi, nëse dikush ka diçka në të ndryshme mund ta marr fjalën.

z. Nuhi Selimi, atë që theksoi z. Shemsi Jashari jemi dakord të gjithë, por do të flisja për arsyen pse nuk janë kryer, apo pse nuk ka pas angazhim si duhet, sepse për angazhim duhet stimulim. Kërkesa është për autoritetin komunal, a ka mundësi që pjesëmarrësve, banorëve të fshatrave dhe vendbanimeve përreth në takimet e KLSP-së për shkak të shpenzimeve të transportit dhe shpenzimeve tjera t'u kompensohet dita sikurse që janë duke vepruar në komunat tjera. Kërkesë tjetër është që ne si anëtarë të Këshillit qysh kur formuar janë paraparë edhe mëditjet, ndërsa nuk janë duke u realizuar. Si autoritet keni deklaruar se do të merreni me këtë çështje. Më intereson të dijë se si qëndron puna, a bëhet pagesa apo jo e anëtarëve të Këshillit, e nëse nuk paguhet të na tregoni arsyen pse nuk mund të bëhet. Nëse këto mëditje nuk paguhet të tregohet arsyeja e mos ekzekutimit të pagesave, por nëse kemi të drejtë pse mos të na bëhet pagesa.

z. Bahri Selimi, theksoi, jam në dijeni se Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e ka dërguar një kërkesë në Ministrinë përkatëse për marrjen e një opinionit rreth çështjes së pagesave por ende nuk kemi marr ndonjë konfirmim nga ana e tyre. Nëse Ministria konfirmon se duhet të bëhet pagesa mendoj se duhet të bëhet pagesa në mënyrë retroaktive. Sa i përket kërkesës së parë sigurisht që nuk ka ndonjë kosto të lartë por problemi qëndron te procedurat ligjore të cilat parashihen për shpenzimin e parasë publike. Megjithatë ne do ta shqyrtojmë këtë çështje me Drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe nëse ekziston mundësia e rregullojmë këtë çështje.

z. Bahri Selimi e përmbylli takimin, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani

Nr. prot.02-060/04-0087369/23

Podujevë, datë: 13.12. 2023

**Kryesuesi i mbledhjes
Drejtori i DSHPMSh, Bahri Selimi**